



QYTETI I SHKUPIT

Në përputhje me nenin 4 të Rregullores për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga buxheti i Qytetit të Shkupit për subvencionim të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2019 me nr. 08-2252/1 të datës 08.03.2019, dhe në lidhje me Vendimin për përcaktimin e vlerës maksimale për ndarjen e subvencionit individual qytetarëve për blerjen e biçikletave në vitin 2019 („Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 02/19), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2019

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim që të stimulojë qytetarët për përdorimin e biçikletave, qytetarëve të cilët do të blejnë biçikletë nga dita e shpalljes së Thirrjes publike 11.03.2019 deri më 30.06.2019, do t'u kompensojë një pjesë të shpenzimeve të bëra për blerjen e biçikletës.

1.2. Mjetet që do t'i subvencionojë Qyteti i Shkupit janë në vlerën prej 50% të vlerës së biçikletës, po jo më shumë se 3.000,00 denarë për person, me tatimin mbi të ardhurat personale të përfshirë.

1.3. Thirrja publike do të realizohet sipas parimit “i pari i arritur, i pari shërbehet”.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në këtë Thirrje publike kanë banorët e Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare), të cilët do të blejnë biçikletë nga dita e shpalljes së Thirrjes publike deri në shterimin e mjeteve në buxhet të dedikuara për atë qëllim, por jo më vonë se 30.06.2019.

3. Kushte që duhet t'i plotësojë aplikuesi

Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë banor i Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare),
- të mos ketë shfrytëzuar subvencion për blerjen e biçikletës nga Qyteti i Shkupit,
- të blejë biçikletën nga dita e shpalljes së Thirrjes publike deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për atë qëllim, por jo më vonë se 30.06.2019.

4. Mënyra e aplikimit për Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve si dhe për dëshmimin se kushtet për pjesëmarrje janë plotësuar, aplikuesi deri te Qyteti i Shkupit duhet të depozitojë:

- kërkesë për subvencionim për blerjen e një biçiklete (Kërkesa mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit ose të sigurohet nga faqja e internetit e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk),
- dëshmi që është banor i qytetit të Shkupit, me depozitimin e kopjes së letërnjoftimit të vlefshëm të aplikuesit,
- fotokopje e llogarisë së transaksionit të aplikuesit
- deklaratë që aplikuesi deri tani nuk ka shfrytëzuar subvencion për blerjen e biçikletës nga Qyteti i Shkupit
- dëshmi se është realizuar blerja e biçikletës, me faturë fiskale origjinale ose faturë me certifikatë nga bankë afariste, me datë nga dita e shpalljes deri në ditën e përfundimit të Thirrjes publike.

4.2. Një person mund të paraqesë vetëm një kërkesë për marrjen e subvencionit për blerjen e një biçiklete.

4.3. Kërkesën për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2019, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, qytetarët në zarf të mbyllur e depozitojnë pranë Komisionit përkatës, nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit, në adresën bul. Ilinden nr. 82, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 15:00.

4.4. Në zarf duhet të shënohet “Thirrje publike për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2019”

4.5. Arkivi i Qytetit të Shkupit aplikimet e pranuar do t'i evidentojë me kohën e saktë të depozitimit (data, ora dhe minuta), për arsye të vendosjes së renditjes sipas së cilës do të shqyrtohen aplikimet.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1. Për realizimin e Thirrjes publike Kryetari i Qytetit të Shkupit formon komision për realizimin e Thirrjes publike për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2019.

5.2. Qyteti i Shkupit, në varësi të dinamikës së arritjes së fletëparaqitjeve, në mënyrë periodike do të njoftojë publikun për mjetet e mbetura, deri në shfrytëzimin e tërësishëm të tyre, por jo më vonë se 30.06.2019.

5.3. Pagimi i mjeteve do të realizohet në mënyrë sukcesive, sipas rendit të aplikimeve të depozituara, deri në plotësimin e buxhetit të parashikuar për këtë qëllim.

5.4. Nëse shterohen të gjitha mjetet e parashikuara financiare, Qyteti i Shkupit do të shpallë përfundimin e Thirrjes publike në ueb-faqen e tij.

Mjetet financiare do të konsiderohen si të shteruara, përkatësisht të ndara kur me propozim të Komisionit, Kryetari i Qytetit do të sjellë aktvendim për pagimin e mjeteve.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës për kompensim

6.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit do të sjellë aktvendim për miratimin e kërkesës së aplikuesve të cilët plotësojnë kushtet në përputhje me Thirrjen publike.

6.2. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit do të njoftojë aplikuesit të cilët nuk kanë plotësuar kushtet në përputhje me Thirrjen publike për mosmiratimin e kërkesës së tyre.

QYTETI I SHKUPIT